



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
REKTORATI

Nr. 1898 / Prot. 3

Vlorë, më. 02.12.2022

VENDIM

NR 27 datë 02. 12. 2022

PËR

MIRATIMIN E STRATEGJISË TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË UNIVERSITETIT  
"ISMAIL QEMALI" VLORE, 2022-2027

Bazuar në nenin 39, pika 1, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, neni 31, pika 9 e Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, të skenarëve të zhvillimit në planin afatmesëm dhe afatgjatë të Planit Strategjik të UV-së, më konkretisht të Linjës strategjike Nr. 1/ "Partneritet dhe kooperim ndërkombëtar" dhe Linjës strategjike Nr. 2/ "Programe ndërkombëtare studimi dhe mobilitete afatgjata", si dhe në urdhërin Nr. 35, datë 29. 03. 2022 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë së Ndërkombëtarizimit", Rektorati, në mbledhjen e zhvilluar në datën 02. 12. 2022,

VENDOSI

1. Të miratojë Strategjinë e Ndërkombëtarizimit të universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, 2022-2027.
2. Ky vendim t'i përcillet për diskutim dhe miratim Senatit Akademik.
3. Bashkëlidhur materiali mbi Strategjinë e Ndërkombëtarizimit të UV-së, 2022-2027 dhe Relacioni përkatës.

REKTOR

Prof. Dr. Roland ZISI

Në mungesë dhe me urdhër

ZV/REKTORE

Prof. Asoc. Frosina Londo Qyrdeti



Adresa / Adress: L. Pavarsia  
Bulevardi Vlorë-Skelë

Web-site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
ZV. REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Nr. 1770 Prot.

Vlorë, më 14 / 11 / 2022

**Lënda:** Relacion mbi Strategjinë e Ndërkombëtarizimit

**PROF. DR. ROLAND ZISI**  
**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**KËTU:**

Bazuar në nenin 39, pika 1, të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026; Neni 31, pika 9 e statutit të Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të skenarëve të zhvillimit në planin afatmesëm dhe afatgjatë të Planit Strategjik të UV- së, më konkretisht të *Linjës strategjike Nr. 1/ “Partneritet dhe kooperim ndërkombëtar”* dhe *Linjës strategjike Nr. 2/ “Programe ndërkombëtare studimi dhe mobilitete afatgjata”*, pjesë e Skenarit të parë “Ndërkombëtarizimit”, si dhe urdhërit Nr. 35 datë 29.03.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë së Ndërkombëtarizimit” është hartuar draft “Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2022-2027” të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë nga grupi i punës.

Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është të përcaktojë objektivat afatmesëm të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë për përmbushjen e vizionit për Ndërkombëtarizimin sipas Strategjisë së Arsimit të Shqipërisë si dhe Planit Strategjik të UV. Vitet e fundit UV ka bërë një progres të ndjeshëm në fushën e ndërkombëtarizimit dhe kooperimit me Institucione të huaja. Në këtë moment UV ka më shumë se 80 marrveshje mirëkuptimi me Institucione të Arsimit të Lartë në Shqipëri, në Rajon, në Europë e më gjerë. Përmes këtyre marrveshjeve UV mundohet të lidhi ura bashkëpunimi në hartimin, aplikimin dhe implementimin e projekteve të përbashkëta, në zhvillimin e studimeve kërkimore shkencore, në ofrimin e programeve të përbashkëta etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE**

**ZV. REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL**

Paraleisht, UV ka 95 marrëveshje ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus +. Këto marrëveshje i kanë dhënë mundësi stafit akademik, stafit ndihmës akademik e administrativ si dhe studentëve të zhvillojnë mobilitete afatshkurtëra në Institucione të Arsimit të Lartë në Europë.

Kjo strategji është në koherencë të plotë me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 si dhe Planin Strategjik të Universitetit. Po ashtu, kjo strategji është në përputhje dhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe më specifikisht me Objektivin Nr. 4 “Edukim Cilësor”.

Strategjia u hartua nga grupi i punës (i cili kishte në përbërje të vet staf akademik nga të gjitha Njësitë Kryesore të UV) duke përdorur qasje të ndryshme me qëllim krijimin e një dokumenti të qëndrueshëm dhe realist. Grupi i punës fillimisht kontrollon me kujdes dokumentacionin ekzistues (Legjislacioni aktual, Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2016-2020 e UV, Plani Strategjik i UV 2018-2024, Statuti dhe Rregullorja e Institucionit si dhe dokumenta të tjera të rëndësishme) me qëllim analizimin e situatës. Në bazë të situatës aktuale zhvilloi dhe një rishikim të kontekstit European dhe se si veprojnë Institucione Eurpiane të Arsimit të Lartë në këtë fushë. Më pas takime informale janë zhvilluar me aktorë të ndryshëm në UV përfshirë pedagogë, student si dhe Sektorin e Marrdhënieve me Jashtë dhe Projektet. Në bazë të këtyre më lart, grupi i punës hartoi draft strategjinë e cila iu përcoll edhe Sektorit të Marrdhënieve me Jashtë dhe Projekteve për komente dhe sugjerime.

Në bazë të këtyre më lart, besoj se kjo strategji përputhet totalisht jo vetëm me vizionin dhe objektivat kryesor të UV por edhe me agjendën e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin European.

Ju faleminderit për bashkpunimin!

**Zv. Rektor**

**Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

Nr. 170/Prot.

Vlorë, më 14 / 11 /2022

Lënda: Kthim përgjigje

**PROF. DR. ROLAND ZISI**  
**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**KËTU:**

I nderuar zoti Rektor,

Në kuadër të urdhërit Nr. 35 datë 29.03.2022 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë së Ndërkombëtarizimit" ju lutem gjeni bashkëlidhur draftin e hartuar nga grupi i punës.

Ju faleminderit për bashkpunimin!

**Grupi i punës**

**Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli – Kryetar**

**Prof. Dr. Nexhip Mërkuri – Anëtar**

**Prof. Asoc. Elenica Pjero – Anëtar**

**Dr. Rezarta Lalo – Anëtar**


**Dr. Pëllumb Cacaaj – Anëtar**



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

# UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

## Strategjia e ndërkombëtarizimit 2022 - 2027



Adresa /Adress: L. Pavarasia,  
Bulevardi Vlorë-Skelë

web-site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)

Page 1 nga 20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMAL' VLORE  
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

## Përmbajtje

Baza Ligjore .....	3
Misioni .....	4
Historia e ndërkombëtarizimit në Universitetin e Vlorës.....	6
Objektiva më të gjera .....	14
Përcaktimi i vlerave në drejtim të ndërkombëtarizimit.....	14
Prioritetet strategjike .....	15
Objektivat Strategjike.....	15
Aspirata jonë .....	15
Analiza SWOT .....	15
Plani i ndërkombëtarizimit për periudhën 2022 - 2027.....	17



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

*Baza Ligjore*

- Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026
- Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë
- Rregullorja e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë
- Plani strategjik i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL


## MISIONI

UV si institucion autonom publik autonom i arsimit të lartë, zhvillon shërbim edukimi akademik, veprimtari shkencore dhe kërkimore, mbështetje dhe këshillim profesional për studentë dhe studjuesit si dhe fusha të tjera të interesit. Ne synojmë të krijojmë dhe mbështesim një universitet në shërbim të vlerave më të larta njerëzore, promotor të zhvillimeve në territor, me shërbime cilësore dhe të integruara jo vetëm në rajonin e Vlorës, por në të gjithë Shqipërinë. Ne synojmë të formojmë dhe të përgatisim, studentë premtues, profesioniste cilësorë në perputhje me trendin e tregut të punës, profesionistë dhe shkencëtarë në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin kombëtar por edhe në atë europian e më gjerë duke kaluar çdo barrierë të lidhur me prejardhjen e tyre sociale, ekonomike apo kulturore.

Roli dhe misioni i UV-s bazohet në shtyllat kryesorë që rreshtojnë:

1. **MËSIMDHËNIA DHE STUDIMI.** Të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, ideve krijuese dhe shkencës në territorin e Shqipërisë nëpërmjet një mësimdhënieje bashkëkohore sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare, Deklaratës së Bolonjës dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.
2. **PROFILI INSTITUCIONAL.** Të stabilizojë një rol drejtues në zhvillimin e arsimit, shkencës, sportit dhe kulturës duke përcaktuar ritmet e rritjes së ekonomisë dhe shoqërisë në rajon dhe më gjerë.
3. **EDUKIMI I VLERAVE:** Të luajë një rol përcaktues dhe dominues në edukimin e vlerave qytetare dhe demokratike për integrimin e shoqërisë në Europë
4. **KËRKIMI SHKENCOR.** Të vazhdojë të zhvillojë dhe të implementojë standartet më të larta për punë kërkimore shkencore bazë dhe të aplikuar me impakt ekonomik dhe social të fuqishëm në rajon.
5. **INFRASTRUKTURA.** Të përdorë në mënyrë sa më efektive burimet ekzistuese njerëzore dhe logjistike të instituionit duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm dhe rritjen e kapaciteteve.
6. **BASHKEPUNIMI/PARTNERITETI.** Të vazhdojë të bashkëpunojë si partner aktiv në të gjitha veprimtaritë e arsimit të lartë në plan kombëtar dhe ndërkombëtar.  
Përsa i takon misionit dhe objektivave në kornizën institucioneve europiane të arsimit të lartë, UV synon:
7. **NDËRKOMBËTARIZIMI.** Të integrohet plotësisht në zonën europiane të arsimit të lartë duke punuar në drejtim të internacionalizimit të instituionit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

8. **SIGURIMI I CILESISË DHE STANDARTEVE.** Të respektojë dhe të zhvillojë punë akademike të cilësisë së lartë në përputhje me standartet europiane ESCO të Komunitetit Evropian
9. **ANGAZHIMI SOCIAL.** Shërbime të efektshme dhe ndikuese në publik dhe në komunitet, programe gjithëpërfshirëse aktiviteteve për zhvillimin e studentëve dhe krijimin e shkencëtarëve të ardhshëm.

Misioni i UV-s është i orientuar edhe në aspektin soial duke synuar në keto drejtime:

1. Të kontribuojë në promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore tek studentët nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë të disiplinave të mësimdhënies dhe kërkimit.
2. Të sigurojë mjetet e nevojshme për një karrierë të suksesshme për studentët, për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.
3. Të sigurojë një rol udhëheqës në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të qytetit të Vlorës dhe më gjerë.
4. Të ndihmojë në përmbushjen e nevojave sociale, kulturore dhe zhvillimore të vendit.

Formulimi i mësipërm i misionit bazohet edhe në Ligjin Nr 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Veçanërisht, është me vlerë për t'u theksuar komponenti arsimor i Universitetit dhe roli i tij në formimin e qytetarit modern për të siguruar arsimimin/edukimin si një e mirë dhe e drejtë shoqërore publike.

Universiteti është një madhështi intelektuale dhe promovon e lufton për respektimin e vlerave themelore njerëzore dhe sociale. Kjo strategji zhvillimi e UV kërkon pjesmarrjen e të gjithë aktorëve sipas qasjes europiane të sistemit me katër helika ku qeverisja qendrore dhe lokale, institucionet akademike, perfaqesues të biznesit dhe shoqërisë civile adresojnë në mënyrë të integruar nevojat e territorit dhe gjejnë zgjidhje efektive për zhvillimin e tij. Në këtë mënyrë ne jo vetëm përmbushim ambicjet tona për të krijuar një Universitet udhëheqës në rajon, por e kthejmë Universitetin në një pol të rëndësishëm zhvillimi, pararojë të inovacionit dhe të teknologjisë. Implementimi i kësaj strategjie do të realizohet vetëm me pjesmarrjen aktive të studentëve, stafit akademik dhe ndihmës akademik, administrativ, shoqërisë civile, si dhe të gjitha palëve të interesuara (alumni, punëdhënësit etj).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

### *Historia e ndërkombëtarizimit në Universitetin e Vlorës*

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë e ka përcaktuar ndërkombëtarizimin si një nga pikat e rëndësishme të zhvillimit strategjik të tij institucional duke u bazuar dhe në Linjën nr.1 të Skenarit të parë "Ndërkombëtarizimi/ Globalizimi i UV-së" të Planit Strategjik të universitetit.

Universiteti ka qenë shumë aktiv dhe i interesuar për zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare përmes programeve të ndryshme me financim të huaj, duke i konsideruar si një faktor kyç i ndërkombëtarizimit të saj.

Universiteti Vlorës numëron 80 marrëveshje mirëkuptimi, të cilat përmbajnë:

1. Ndarjen e praktikave më të mira, përmirësimi i formave dhe metodave të organizimit të procesit të mësimdhënies, prezantimi me teknologjitë e fundit në procesin mësimor.
2. Kryerjen e analizave të përbashkëta të materialeve (shkencore, metodologjike, tekstet shkollore, ndihmat edukative, kurset, ligjëratat, etj.) në formë të shkruar dhe elektronike.
3. Shkëmbimin e botimeve dhe literaturave shkencore të reja midis bibliotekave.
4. Lektorë të ftuar nga fakultete të kualifikuara për mbajtjen e leksioneve në lidhje me fusha të ndryshme të shkencës, organizimin e seminareve të përbashkëta për përmirësimin e kualifikimit të personelit deri në 15 persona në një vit.
5. Shkëmbimin e informacionit mbi hulumtime, konferenca shkencore dhe simpoziume për të mundësuar pjesëmarrjen në aktivitete të ngjashme.
6. Zhvillimi i kërkimeve të përbashkëta shkencore, shkëmbimi i rezultateve të hulumtimit me qëllim kryerjen e konsultimeve shkencore, seminareve, kërkimeve etj.
7. Shkëmbim eksperience në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të institucionit me përdorimin e teknologjive të informacionit.
8. Mbajtjen e seminareve/takimeve të përbashkëta në lidhje me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në institucion.
9. Organizimi i shkëmbimit të studentëve midis dy institucioneve (deri në 30 studentë në vit).
10. Zhvillimin dhe ofrimin e programeve të përbashkëta duke nënshkruar marrëveshje specifike për programin konkret të studimit, ku duhet të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij (si autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik etj.). Kjo marrëveshje specifike mund të jetë edhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore, lloji dhe modeli i diplomës (e dyfishtë, e përbashkët, e shumëfishtë), i miratuar nga të dy institucionet e arsimit të lartë.
11. Zhvillimin e programeve të veçanta akademike afatshkurtra (si kurse për edukimin në vazhdim me kohëzgjatje deri në 1-vit, programe me karakter profesional me kohëzgjatje 1-2 vjet).
12. Krijimin e fushave të tjera në të cilat është krijuar ose do të zhvillohet interesi i përbashkët reciprok për bashkëpunim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Senati Akademik i UV-së në 16 Maj 2018 miratoi me vendimin nr. 19 një rregullore të brendshme e emërtuar “ Rregullore për Implementimin e Marrëveshjeve Ndër-institucionale në kuadër të Programit Erasmus+ KA107 International Credit Mobility”. Rregullorja është hartuar sipas Udhëzuesit të Programit Erasmus+, Udhëzimeve për ICM dhe praktikave më të mira të institucioneve partnere, e cila garanton një mënyrë të drejtë, transparente, koherente dhe të dokumentuar, duke filluar nga procesi i aplikimit deri në realizimin e tij. Institucionalizimi i procedurës së mobilitetit ka rritur numrin e marrëveshjeve ndërkombëtare jo vetëm në mobilitete, por edhe në projekte të ndryshme zhvillimi duke zgjeruar në këtë mënyrë hartën e bashkëpunimeve me vendet e Bashkimi Europian e më gjerë. 95 marrëveshje ndërinstitucionale renditen në listën e UV-së në kuadër të programit Erasmus + ICM. Më poshtë prezantohet një listë e detajuar e marrëveshjeve dhe mobiliteteve vitet e fundit.


Tabela 1. Ndërkombëtarizimi i UV në numëra

Përshkrimi	Maj 2018 – Tetor 2022
Marrëveshje të mirëkuptimit	53
Marrëveshje ndërinstitucionale	81
Mobilitete student hyrës dhe dalës	171
Mobilitete staf hyrës dhe dalës	393




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

### Marrëveshje ndërkombëtare



### Mobilitete studentë






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL



Falë numrit të madh të marrëveshjeve ndërkombëtare të UV-së, është e mundur që një deri në trembëdhjetë studentë të UV-së të fitojnë një bursë Erasmus + të paktën një herë brenda një cikli studimi në një nga universitetet partnere.

Gjithashtu, ndërkombëtarizimi ka patur një impakt dhe të stafi duke përfitur nga mobilitetet dhe pjesëmarrja në projekte të ndryshme me financim të huaj si mëposhtë vijon:

- Inovacion dhe modernizim të praktikave dhe metodave të mësimdhënies.
- Shkëmbimi i përvojave, rrjetëzimi dhe ndarja e praktikave më të mira mes kolegëve nga universitetet ndërkombëtare.
- Rritja e kapaciteteve dhe vazhdimi i kualifikimit.
- Identifikimi i praktikave të mira dhe veprimeve të rekomandimeve, të cilat përmbushin nevojat dhe interesat e përbashkëta të institucioneve partnere.
- Zbatimi i praktikave më të mira dhe aplikimi i njohurive dhe aftësive të reja që përmirësojnë performancën e tyre në punë.
- Motivimi për mësimdhënie/trajnim.
- Zhvillimi i aftësive të gjuhëve të huaja dhe aftësive për të punuar në një mjedis multikulturor.
- Të fituarit e një këndvështrimi të ri të punës së tyre.
- Zgjerimi i kontakteve të reja profesionale në nivel ndërkombëtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, përmes projekteve me financim të huaj ka rritur në mënyrë të vazhdueshme si vijon:

- Kapacitetet e personelit akademik/ ndihmësakademik dhe administrativ
- Ngritje apo pasurim i infrastrukturës didaktike apo kërkimore shkencore.
- Pagesë stafi për angazhimin në implementimin e projekteve
- Pasurimi me literaturë i bibliotekës së UV-së
- Krijimi i qendrave të reja të inovacionit/ start up etj.
- Organizimi i konferencave shkencore apo publikimi i punimeve të ndryshme shkencore etj.

UV numëron mbi 30 projekte me financim të huaj në kuadër të programit Erasmus+ CBHE, Interreg, IPA Cross-Border etj, prej të cilave universiteti ka përfituar. Përvoja e gjatë dhe e sukseshme e Universitetit të Vlorës në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve me financim të huaj e ka theksuar universitetin si një partner i drejtë dhe të besueshëm. Gjithashtu, nëpërmjet projekteve me financim të huaj në kuadër të programit Erasmus+ CBHE me objektiv kryesor hapjen e programeve ndërkombëtare në UV për herë të parë planifikohet të hapet një program ndërkombëtar me akronimin MEP&M. Universiteti i Vlorës është anëtar i disa shoqatave dhe rrjeteve ndërkombëtare të arsimit të lartë, të cilat kanë ndihmuar në rritjen e imazhit të universitetit në arenën ndërkombëtare dhe forcimin e bashkëpunimeve ku përmendim UNIMED, ASECU, EUCEN, MAGNA CARTA, CMU, etj. UV është shumë aktiv në ndërmarrjen dhe pjesëmarrjen e aktiviteteve të shpërndarjes së informacionit në kuadër të projekteve me financim të huaj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
 ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL



**"Nothing is difficult if you really want something"**

**NEO ALBANIA**

**My Journey towards Erasmus**


**Approved Erasmus mobility in Albania**

**My Erasmus My Athens**



The Erasmus mobility program is a great opportunity for students to gain international experience and improve their language skills. I was lucky to be selected for the program and to spend my time in Athens, Greece. The experience was amazing and I learned a lot from it. I met many new people and made friends who will stay with me for life. I also improved my English and learned a lot about the Greek culture and history. I highly recommend the Erasmus program to all students who want to broaden their horizons and gain valuable experience.

Adresa /Adress: L. Pavarësia,  
 Bulevardi Vlorë-Skëlë

web-site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
 e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL



Universiteti "Ismail Qemali", vlorë ka arritur të ketë disa vlerësime të rëndësishme në kuadër të ndërkombëtarizimit si vijon:

- UV është vlerësuar si "Praktikë e mirë" për implementimin e ICM, prej Zyrës Kombëtare Erasmus+ në Shqipëri si dhe prej universiteteve të vendeve të programit si Universiteti i





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Padovës dhe Universiteti i Pireut. Gjithashtu, sipas Komisionit European për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", renditet në katër universitetet shqiptare që vlerësohen si partnerë shumë aktivë për sa i përket marrëveshjeve të bashkëpunimit në komponentin ICM.

- Universiteti i Vlorës është renditur i 42-i në botë për vitin akademik 2020-2021 dhe i 35-ti për vitin akademik 2021-2022 prej WURI (World's Universities with Real Impact) në fushën "Mobility of students and openness". Universiteti i Vlorës duke aplikuar në këtë fushë prezantoi arritjet e 4 viteve të fundit, me numrin e lartë të studentëve të UV të cilët kanë ndjekur studime në Universitete Europiane, studentët e huaj të cilët kanë zhvilluar studime në UV, pedagogë si dhe stafi administrativ të cilët kanë zhvilluar leksione dhe/ose trajnime në Universitete Europiane si dhe stafi i huaj që ka realizuar leksion/trajnim në UV. Gjithashtu, ndikim pozitiv në këtë vlerësim pati dhe i gjithë kuadri rregullator i miratuar dhe i zbatuar në UV dhe transparenca e gjithë procesit përsa i përket komponentit ICM.
- Mbështetur në tre shtyllat tematike si Zhvillimi i Kurrikulave; Qasjet Inovative në Mësimdhënie e Mësimnxënie dhe Mobilitetet dhe Ndërkombëtarizimi, në kuadër të projektit "Bologna Hub Peer Support" (financuar prej Komisionit European dhe Ministrisë Federale të Edukimit dhe Kërkimit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në Shqipëri; Ministrinë e Edukimit dhe Shkencës në Ukrainë; Ministrinë e Edukimit, Shkencës, Kulturës dhe Sportit në Gjeorgji; Universitetin Espanolas; Uninonin European të Studentëve si dhe Akademinë Gjermane të Shkëmbimit të Shërbimeve), ekspertët e huaj kanë vlerësuar si praktika të mira një sërë aspektesh në UV si:
  - a) masat e ndërmarra për të stimuluar përfshirjen e stafit në aktivitete ndërkombëtare,
  - b) numrin e lartë të marrëveshjeve të partneritetit në kuadër të Erasmus+,
  - c) bashkëpunimet dypalëshe,
  - d) strategjinë aktive në kuadër të mobiliteteve,
  - e) përpjekjet për të luajtur një rol kyç në zhvillimin e rajonit.

The best practice video. Video e organizuar në kuadër të ditëve Erasmus 2020 prej SPMJ me studentët e UV-së, përfitues të programit, u vlerësua praktikë e mirë prej ZKE+ ([https://erasmusplus.al/ep-content/uploads/2020/11/ErasmusDays\\_NEOAlbania.pdf](https://erasmusplus.al/ep-content/uploads/2020/11/ErasmusDays_NEOAlbania.pdf)) dhe Delegacionit European në Shqipëri.

Gjithashtu, një vlerësim pozitiv, kjo video mori dhe nga Agjencia Franceze Erasmus+ (<https://agence.erasmusplus.fr/wp-content/uploads/2020/12/ErasmusDays-2020-coverage-and-impact-1.pdf>), e cila është dhe iniciatore e celebrimit të ditëve erasmus.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

### *Objektiva më të gjera*

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" synon të bëhet një nga më të pëlqyerit mes universiteteve shqiptare në mbarë botën duke forcuar orientimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Objektivi kryesor është krijimi i një profili të besueshëm dhe profesional në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të projekteve kërkimore-zhvilluese dhe bashkëpunimit për ngritjen e kapaciteteve reciproke.

Në arritjen e këtij synimi, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" kërkon të bëhet selia e vlerave dhe takimeve kulturore jo vetëm nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, por edhe përmes promovimit të tolerancës ndaj, respektimit dhe njohjes së kulturave të tjera.

Për të përmbushur objektivat e përgjithshme, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" ka vendosur një sërë objektivash afatgjata, të cilat fokusohen në këto aspekte strategjike:

- Partneriteti institucional;
- Përvoja ndërkombëtare për studentët si dhe stafin akademik dhe administrativ,
- Ndërkombëtarizimi i programeve dhe kurrikulave,
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe transferimit të njohurive dhe teknologjive.

### *Përcaktimi i vlerave në drejtim të ndërkombëtarizimit*

UV nuk është thjesht një vend ku mundohet të gjeneroj njohuri për shoqërinë, por paralelisht mundohet të kthehet gjithnjë e më shumë në një institucion për të krijuar njohuri që kanë edhe vlerë ekonomike. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë është një fenomen natyror dhe një mundësi inkurajuese për zhvillim dhe krijimtari. Përparimi i ndërkombëtarizimit duke u fokusuar në tërheqjen e më shumë studentëve ndërkombëtarë është pika kryesore strategjike. Me ndërkombëtarizimin, arsimi jo vetëm që zhvillon të menduarit kritik dhe arsyetimin logjik të studentëve, por ata janë gjithashtu të përgatitur dhe të pajisur mirë për t'u angazhuar me njerëz dhe biznese të tjera nga vende të tjera, kudo që të jenë, dhe kjo u hap atyre më shumë mundësi. Funksionimi i UV në një botë të globalizuar pa marrdhënie ndërkombëtare është jo efektive dhe në aspektin afatmesëm dhe afatgjatë jo rezultative. Megjithatë ndërkombëtarizimi është një koncept kompleks dhe i shumëanshëm që përfshin shumë elementë, ky proces i përgjigjet nevojave lokale dhe globale. Ndërkombëtarizimi fuqizon studentët, stafin dhe institucionet me "mësime" nga institucionet e avancuara jashtë vendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

### *Prioritetet strategjike*

- Rritja e numërit të marrveshjeve efektive me institucione të huaja;
- Ofrimi i programeve të përbashkëta;
- Kërkime shkencore dhe projekte të përbashkëta me Institucione të huaja;
- Rritja e numërit të mobiliteteve;

### *Objektivat Strategjike*

Objektivat strategjikë synojnë përfshirjen e universitetit në aktivitete dhe ndërmarrje të reja drejt ndërkombëtarizimit. Ato përfshijnë:

- 1) Promovimi i lëvizshmërisë për studentët dhe stafin, akademik dhe administrativ.
- 2) Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe transferimit të njohurive dhe teknologjive.
- 3) Forcimi i lidhjeve me diasporën shkencore shqiptare.
- 4) Rritja e dukshmërisë ndërkombëtare të universitetit në rajon dhe më gjerë.
- 5) Përforcimi i shërbimeve mbështetëse administrative për zbatimin e projektit dhe marrëdhëniet me jashtë.
- 6) Ndërkombëtarizimi i programeve dhe kurrikulave.
- 7) Ndërgjegjësimi i komponentit ndërkulturor në raport me partnerët ndërkombëtarë.

### *Aspirata jonë*

Të rrisim reputacionin tonë ndërkombëtar duke ofruar cilësi të lartë në mësimdhënie, kërkim shkencor i cili i përgjigjet nevojave ndërkombëtare të një bote të globalizuar dhe partneritet me të tretët me qëllim transferimin e njohurive dhe shërbimeve.

### *Analiza SWOT*

#### **Pika të forta**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

- Numër i madh marrveshjesh bashkëpunimi me Institucione Europiane
- Numër i madh marrveshjesh ndërinstucionale me Institucione partnere në vende të Programit Erasmus;
- Numër i madh i pedagogëve të angazhuar për bashkëpunime ndërkombëtare
- UV është anëtar në disa rrjete Universitetesh ndërkombëtare të rëndësishme
- Pikë strategjike e Institucionit ndërkombëtarizimi
- Pozicioni i Vlorës i cili e bën atraktiv për studentë e staf ndërkombëtar
- Zyrë të marrdhënieve ndërkombëtare të konsoliduar dhe me eksperiencë
- Mbështetje nga autoritetet drejtuese për pedagogët për pjesmarrje sa më të madhe në aktivitete ndërkombëtare
- Numër i madh aplikimesh në projekte me financim të huaj me qëllim rritjen e kapaciteteve
- Rankim i lartë i UV në krahasim me universitetet e tjera rajonale në Shqipëri

#### Pika të dobta

- Mungesë e studentëve ndërkombëtar
- Mungesë e programeve të studimit në gjuhë të huaj
- Mungesë e programeve të studimit në gjuhë të huaj
- Mos bashkëpunim të disa Departamenteve në procesin e ndërkombëtarizimit
- Mungesë e metodave alternative të mësimdhënies
- Mungesë e bashkëpunimit dhe projekteve me financim të huaj për kërkimin shkencor
- Mungesë e një procesi të konsoliduar për të thithur kërkues shkencor të huaj si dhe visiting professors
- Mungesa e pedagogëve që japin leksione në Universitete të huaja ose profesorëve të huaj
- Mos bashkëpunim me anëtarë të alumni të cilët jetojnë jashtë Shqipërisë
- Mos angazhim i Bordit Konsultativ
- Mos angazhim i personave të Dekoruar me Doktor Honoris Causa

#### Mundësitë

- Partneritete në mbështetje të aktiviteteve universitare
- Interes për zgjerimin e programeve akademike
- Interes për ofrimin e programeve të përbashkëta/dyfishta
- Interes për zhvillimin e aktiviteteve kulturore e sociale në nivel ndërkombëtar edhe/ose në bashkëpunim me institucione të huaja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

- Potencial për zhvillim ndërkombëtar
- Ofrim i programeve akademike me kosto të ulët për studentët e huaj në krahasim me Universitete të tjera ndërkombëtare
- Fokus i veçantë i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në ndërkombëtarizimin e Universiteteve
- Mundësi për hapje programeve të përbashkëta/dyfishta duke përdorur financim të projekteve Europiane

### Rreziqet

- Mungesë e financimit adekuat
- Ulja e numërit të studentëve
- Mungesë e incentivave për pedagogët për pjesmarrje në aktivitete ndërkombëtare
- Mos-miratimi nga Ministria i programeve të reja të studimit përfshirë dhe atyre të përbashkëta/dyfishta
- Mungesë e njohurive dhe eksperiencës në procesin e ndërkombëtarizimit

### Plani i ndërkombëtarizimit për periudhën 2022 - 2027

Objektivi	Aktivitetet	Strukturat mbështetëse	Periudha
Ndërkombëtarizimi përmes Kërkimit Shkencor	<ul style="list-style-type: none"><li>- Bashkëpunim me universitete prestigjioze ndërkombëtare</li><li>- Publikim i artikujve shkencor në revista ndërkombëtare;</li><li>- Organizim i aktiviteteve të përbashkëta (konferenca, seminare, ëorkshop) me IAL të huaja;</li><li>- Rritje e pjesmarrjes në projekte ndërkombëtare</li><li>- Thithja e kërkuesve shkencor dhe pedagogëve me eksperiencë ndërkombëtare;</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Njësitë Kryesore</li><li>- Njësitë Bazë</li><li>- Sektori i marrdhënieve me jashtë</li><li>- Sektori i financës</li></ul>	2022-2027



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

	<ul style="list-style-type: none"><li>- Aplikimi në projekte kërkimore shkencor ndërkombëtare</li></ul>		
Ndërkombëtarizimi përmes mësimdhënies	<ul style="list-style-type: none"><li>- Ofrimi i programeve të studimit në gjuhë të huaj</li><li>- Ofrimi i programeve të studimit të dyfishta/përbashkëta</li><li>- Mundësi për thittje të studentëve të huaj</li><li>- Rritje e mobiliteteve të stafit akademik për mësimdhënie në Universitete të huaja</li><li>- Rritje e mobiliteteve të studentëve për zhvillimin e një periudhe të studimeve në Universitete të huaja</li><li>- Rritja e numërit të pedagogëve të huaj të ftuar (visiting professors)</li><li>- Bashkëpunim më i mirë me rrjetin e personave të dekoruar me titullin Doctor Honoris Causa</li><li>- Rritje e marrveshjeve ndërinstitucionale me Universitete Europiane</li><li>- Incentiva për stafin akademik të marri pjesë në aktivitete ndërkombëtare</li><li>- Incentiva për studentët të marrin pjesë në mobilitete për zhvillim të një pjesë të studimeve</li><li>- Riorganizimi i kurrikulave me qëllim të përshtatën nevojave të tregut ndërkombëtar</li><li>- Ndërtimi i një rrjeti studentësh ambasador të</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Senati Akademik</li><li>- Bordi i Administrimit</li><li>- Njësitë Kryesore</li><li>- Njësitë Bazë</li><li>- Sektori i marrdhënieve me jashtë</li><li>- Sektori i financës</li></ul>	2022-2027



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENÇOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

	<p>UV-së të cilët kanë marrë pjesë në mobilitete ndërkombëtare</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Bëja e institucionit më atraktiv për studentë të huaj</li><li>- Ofrimi i kurseve të gjuhës angleze për pedagogët e UV</li><li>- Përmirësimi i aftësive të mësimdhënies për pedagogët e UV përmes trajnimeve të ndryshme</li><li>- Kërkesë Ministrisë për mundësinë e ofrimeve të leksioneve në mënyrë hibride</li></ul>		
Rritja e vizibilitetit të Institucionit në nivel ndërkombëtar	<ul style="list-style-type: none"><li>- Ofrimi i gjithë informacionit të ëbsite të UV në gjuhën angleze e italiane</li><li>- Përkthimi i gjithë dokumentacionit të UV në gjuhën angleze</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Sektori i IT-së</li><li>- Sektori i Komunikimit</li></ul>	2022-2027
Përmirësimi i kushteve për studentët e huaj që frekuentojnë studime në UV	<ul style="list-style-type: none"><li>- Ofrimi i guidave specifike për studentët e huaj</li><li>- Facilitim i studentëve në gjithë procesin e aplikimit, lejes së qëndrimit, akomodimit etj.</li><li>- Krijimi i një rrjeti studentësh të huaj që kanë frekuentuar studimet e tyre për një periudhë në UV (funksionimi i tyre si ambasadorë për UV në vendet e tyre)</li><li>- Ofrimi i bursave për studentët e huaj ekselent që zgjedhin UV për studimet e tyre</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Njësitë Kryesore</li><li>- Njësitë Bazë</li><li>- Sektori i marrdhënieve me jashë</li><li>- Sektori i financës</li><li>- Sektori i aktiviteteve sportive dhe alumni</li></ul>	2022-2027



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
REKTORI

Vlorë më, 16 .11. 2022

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

Drejtuar:

- Senati
- Rektorati
- Këshilli i Etikës
- Rektori
  - Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal
  - Sektori Juridik
  - Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore
    - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
    - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
    - Sektori i IT-së
- Bordi i Administrimit
- Administrator
  - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
  - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
  - Sektori i Prokurimeve
  - Sektori i Shërbimeve
- Njësia e Auditit të Brendshëm
- Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional
  - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve
  - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
  - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik
- Zv. Rektor Akademik
  - Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë
  - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
  - Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
- Sektori i Bibliotekes Shkencore
  
- Prof. Asoc. Aurela Saliaj      Dekan F.SH.
  - Kryesekretare                      F.SH.
- Prof. Dr. Albert Qarri      Dekan F.E
  - Kryesekretare                      F.E
- Prof. As. Armela Panajoti      Dekan F.SH.H.D
  - Kryesekretare                      F.SH.H.D
- Prof.As. Hajdar Kicaj      Dekan F.SH.T.N
  - Kryesekretare                      F.SH.T.N

REKTORI  
Prof. Dr. Roland ZISI